

Jeta dhe veprimtaria shkencore

Agnja Vasiljevna Desnickaja
(1912 - 1992)

Ishte filologe me prejardhje nga ish Bashkimi Sovjetik, organizatore e shkencës, pedagoge, specialiste e disa fushave të gjuhësisë, sidomos e gjuhësisë krahasimtare - historike dhe e gjermanistikës. Ishte albanologe e njohur, njohëse e i mirë e literaturës dhe e folkloristikës shqiptare, e ballkanologjisë dhe të shumë gjuhëve indoevropiane. Ishte themeluese e shkollës së albanologjisë në BRSS. Në vitin 1946 kishte doktoruar në shkencat filologjike dhe më vonë kishte marrë thirrjen profesoreshë, ndërsa gjatë viteve 1963 - 1976 kishte qenë drejtoreshë e Institutit të Gjuhësisë në ASH të BRSS - së. Që nga viti 1964 kishte qenë antëtare me korrespondencë e ASH të BRSS - së nga Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë.

Në Prishtinë **A. Desnickaja** ka marrë pjesë shpeshherë në **Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhë, Letërsi dhe Kulturë Shqiptare**, në kuadër të të cilit ka mbajtur ligjërata dhe ka lexuar kumtesa në sesionet shkencore. Ka marr pjesë në simpoziume e konfereca shkencore që organizoheshin në Prishtinë dhe Tiranë lidhur me çështje të ndryshme të gjuhësisë shqiptare e më gjerë. Ka botuar shumë shkrime në revistat „*Gjurmime albanologjike*“ dhe „*Gjuha shqipe*“ të Institutit Albanologjik të Prishtinës, në periodikun e Fakultetit Filologjik të UP - së dhe të ASHAK etj. Pra, ka qenë shumë e pranishme me shkrimet e saj shkencore në Kosovë dhe në Shqipëri.

VEPRAT MË TË NJOHURA TË SAJ:

Албанская литература и албанский язык. Л., 1987, 293 с.

Албанский язык и его диалекты. Л., 1968, 377 fq. (Është përkthyer dhe botuar edhe në Prishtinë me titull: „Gjuha shqipe dhe dialektet e saj“, nga ETMM, 1972, 314 fq.).

Вопросы изучения родства индоевропейских языков. М. - Л., 1955, 332 fq. .

Наддиалектные формы устной речи и их роль в истории языка. Л., 1970, 98 fq. .

Сравнительное языкознание и история языков. Л., 1984, 350 fq.

Чередование гласных в германских языках (аблаут). М. - Л., 1937, 148 fq.

E përgatiti: Agim SPAHIU